




Ky projekt financohet nga
Bashkimi Evropian

arise Action for Reducing
Inequalities in Education

ARISE

Iniciativa
për zvogëlimin
e pabarazive
në arsim

Raport kombëtar për Kosovë



ARISE

Iniciativa për zvogëlimin e pabarazive në arsim
Raport kombëtar për Kosovë

Publikuar nga
Kosova Education Center (KEC)

Për publikuesin
Dukagjin Pupovci

Autore
Ema Rraci

Dizajni
Ivana Zoranović
Zoran Grac

Ky publikim është realizuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e autorit dhe nuk pasqyron medoemos pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Qendra për Arsim e Kosovës

ARISE

Iniciativa për zvogëlimin e pabarazive në arsim

Raport kombëtar për Kosovë

Prishtinë, 2021

Konzorciumi i Projektit ARISE



Centar za obrazovne politike
Centre for Education Policy



Tabela e përmbajtjes

Lista e shkurtesave	5
Hyrje	7
1. Konteksti i përgjithshëm i politikave që kanë të bëjnë me barazinë	8
1.1. Varfëria si burim i pabarazisë	9
2. Barazia në arsim	12
3. Politikat ekzistuese që kanë synim zvogëlimin e pabarazisë	16
3.1. Sistemi arsimor në Kosovë	16
3.2. Sistemi i kujdesit shëndetësor	22
3.3. Sistemi i kujdesit dhe mirëqenies sociale	24
4. Analiza e reformës në arsim dhe barazia	27
5. Përfundimet kryesore dhe rekomandimet	32






Lista e shkurtesave

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
DKA	Drejtoria Komunale për Arsim
DKSHMS	Drejtoritë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
EPRBM	Ekipet për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit në arsimin e obligueshëm
ESCS	Indeksi i PISA-s për gjendjen ekonomike, sociale & kulturore
IKSHP	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik
ISCED	Klasifikimi Ndërkombëtar i Standardeve në Arsim
KKK	Korniza Kurrikulare për Arsimin Parauniversitar në Kosovë
MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MSH	Ministria e Shëndetësisë
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
QM	Qendrat Mësimore
QPS	Qendra për Punë Sociale
SAS	Skema e Asistencës Sociale
SMIA	Sistemi për Menaxhimin e Informatave në Arsim
SPH	Sistemi i Paralajmërimit të Hershëm
SSE	Statusi Socio-Ekonomik
UA	Udhëzim Administrativ
ZKKK	Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim





Hyrje

Ky raport kombëtar është përgatitur në kuadër të projektit “Iniciativa për zvogëlimin e pabarazive në arsim” (ARISE¹), një projekt ky rajonal që zbatohet në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, Maqedoni të Veriut, Serbi dhe Turqi dhe që financohet nga Komisioni Evropian. Ky projekt ka për qëllim që të mbështesë përfshirjen e nxënësve me status të ulët socio-ekonomik përmes ndërtimit të partneriteteve kombëtare dhe rajonale të organizatave të shoqërisë civile nga gjashtë përfituesit e sipërpërmendur, angazhimit në avokim dhe dialog konstruktiv me qeveri për politika, rritjes së vetëdijesimit në mesin e palëve të interesit në arsim dhe intervenimeve pilot që synojnë nxënësit me SSE të ulët në nivel shkollor.

Të dhënat dhe informatat e prezantuara në këtë raport kombëtar janë mbledhur përmes një pyetësori mbi politikën, i realizuar pas analizës së dokumenteve të politikave që kanë të bëjnë me barazinë, dhe konsultimeve me institucione përkatëse dhe ekspertë si dhe fokus grupe dhe intervista me politikëbërës, drejtorë të shkollave, mësimdhënës, personel mbështetës në shkolla, nxënës, prindër, organizata të shoqërisë civile dhe ekspertë arsimorë. Fokus grupet dhe intervistat janë realizuar për të parë perspektivën e palëve të interesit mbi çështjet e ndërlidhura me barazinë në përgjithësi dhe në kontekstin arsimor të një vendi.



.....

1 Për më shumë informata për projektin: <https://www.arisenetwork.eu/en/>

1. Konteksti i përgjithshëm i politikave që kanë të bëjnë me barazinë

“Ne, Populli i Kosovës, të përkushtuar për krijimin e një shteti të qytetarëve të barabartë, i cili do të garantojë të drejtat e secilit qytetar, liritë qytetare dhe barazinë e të gjithë qytetarëve para ligjit; të zotuar që Kosova të jetë shtet i mirëqenies ekonomike dhe i prosperitetit social”² janë fjalët e para të Kushtetutës së Kosovës, të cilat garantojnë barazi dhe prosperitet social për të gjithë shoqërinë, pa marrë parasysh gjininë, racën, etninë, fenë, statusin e tyre ekonomik etj. Në përputhje me këtë zotim, Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë, i themeluar në vitin 2000 mbron të drejtat dhe liritë e njeriut si dhe monitoron trajtimin e barabartë, pa diskriminim mbi ndonjë bazë, i mbrojtur me Ligjin për Barazi Gjinore dhe Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të cilët së bashku me Ligjin për Avokatin e Popullit përbëjnë pakon ligjore për të drejtat e njeriut në Kosovë.

Ngjashëm, Ligji për Arsimin Parauniversitar në Kosovë, Ligji për Arsimin në Komunitet në Kosovë dhe Ligji për Edukimin Parashkollor, theksojnë parimet e barazisë në sistemin arsimor, duke garantuar kështu që të gjithë nxënësit kanë të drejtë për qasje në arsim cilësor pa marrë parasysh racën, fenë, etninë dhe aftësitë e tyre. Mbi këtë temë, ekziston një konsensus i përgjithshëm që Kosova ka një kornizë ligjore dhe kushtetuese shumë të avancuar për sa i përket barazisë. Në anën tjetër, termi “drejtësi”, i cili ka për qëllim të adresojë dallimet fundamentale në mundësi dhe qasje në burime, nuk përdoret drejtpërdrejt në dispozitat ligjore, por lihet të nënkuptohet. Për shembull, sa i përket drejtësisë në arsim, Kosova garanton që të gjithë nxënësit të kenë përvojë të njëjtë në shkollim, i cili është falas për të gjithë nxënësit që regjistrohen në arsimin fillor dhe të mesëm të lartë.

2 Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Kosovë, 2008. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

Kosova ofron qasje universale në shërbime publike, në veçanti në shëndetësi dhe arsim. Po ashtu, ka edhe kuota që përkrahin qasjen në arsim, punësim për grupet e cënueshme/jo të favorshme si dhe ka masa për përmirësimin e mirëqenies sociale, të cilat do të diskutohen më në hollësi në pjesët e tjera të këtij raporti. Sido që të jetë, përkundër faktit se masat e tilla rrjedhin prej kornizës ligjore dhe kushtetuese, fatkeqësisht në Kosovë ka shumë pabarazi, ku qasja e njerëzve në institucione kryesore dhe në mundësi vazhdon të përcaktohet me statusin e tyre politik, ekonomik dhe social, që shpesh shpie në përjashtim social. Kjo si pasojë fuqizon pabarazinë dhe padrejtësinë në kontekst të qasjes së tyre në burime, zgjedhje dhe mundësi, që çojnë në një cikël vicioz të pabarazisë e cila kalon prej një gjenerate në tjetrën.

Hulumtimet e organizatave vendore dhe ndërkombëtare si dhe raportet e mediave tregojnë se diskriminimi, stigma dhe neglizhenca sociale ende janë të pranishme në shoqërinë kosovare, në veçanti karshi grupeve të pafavorizuara, si komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, personave me nevoja të veçanta dhe personave me status të ulët socio-ekonomik. Mbi këtë çështje, diskutime të gjata me palë interesi në arsim, përfshirë mësimdhënësit, drejtorët e shkollave, përfaqësuesit e DKA-ve, MASH-it dhe OShC-ve tregojnë se Kosova e njëj barazinë dhe ka të përgatitur një kornizë ligjore të avancuar që siguron barazi dhe paanshmëri, megjithatë zbatimi i saj i duhur në praktikë ende mbetet sfidues.

1.1. Varfëria si burim i pabarazisë

Varfëria në Kosovë matet me përqindje të popullsisë, e cila nuk e kalon pragun e të hyrave të caktuara, të përcaktuara nga institucionet zyrtare. Në këtë kuptim, në Kosovë ekzistojnë dy linja të varfërisë të cilat përdoren për të matur varfërinë, respektivisht: 1) linja e varfërisë, e cila konsiderohet e duhur për të plotësuar nevojat bazike dhe 2) varfëria e skajshme. Në vitin 2017, pas përshtatjes me inflacionin, pragu i varfërisë dhe varfërisë së skajshme ishte 1.85 € dhe 1.31 € për ekuivalentin për të rritur në ditë.³


Nga sa u tha më sipër, Kosova është një prej vendeve me shkallën më të lartë të varfërisë në Evropë dhe që nga viti 2017 rreth 18% e

3 Varfëria në konsum në Republikën e Kosovës. Banka Botërore Kosovë, maj 2019. <http://documents1.worldbank.org/curated/en/210201560762490515/pdf/Consumption-Poverty-in-the-Republic-of-Kosovo.pdf>



popullsisë së Kosovës jeton nën kufirin e varfërisë me më pak se 1.85 euro në ditë, ndërsa 5.1% e popullsisë jeton nën kufirin e varfërisë së skajshme me më pak se 1.31 euro për ekuivalentin për të rritur në ditë (Figura 1).⁴

Figura 1: Varfëria dhe varfërisa e skajshme 2012 - 2017



Burimi: ASK, 2019

Grupe të caktuara, përfshirë popullsinë rurale, gratë, fëmijët, të papunët dhe minoritetet etnike janë më të ndjeshme ndaj varfërisë. Të dhënat e ofruara në këtë raport mbi varfërinë në konsum në Kosovë tregojnë se niveli i varfërisë dhe varfëria e skajshme janë më të larta në zonat rurale krahasuar me ato urbane.⁵ Po ashtu, siç pritet, ka një raport të fuqishëm midis nivelit të arsimit dhe shkallës së varfërisë, e cila tregon se individët që nuk kanë arsimimin bazë kanë më shumë tendenca për të jetuar dhe për të mbetur në varfëri krahasuar me ata që kanë nivel më të lartë të arsimit.⁶ Që këtej, në vitin 2017, shkalla e varfërisë tek individët që nuk e kanë përfunduar arsimin fil-lor ishte 21.5% krahasuar me shkallën e varfërisë prej 5.5% tek indi-

4 Varfëria në konsum në Republikën e Kosovës. Banka Botërore Kosovë dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës, maj 2019. <https://ask.rks-gov.net/media/4901/poverty-statistics-2012-2017.pdf>

5 Si më lart.

6 Si më lart.

vidët që e kanë përfunduar arsimin terciar.⁷ Në bazë të kësaj, mund të argumentohet se arsimi luan një rol të rëndësishëm në thyerjen e ciklit të varfërisë, meqë kjo hap derën për vende pune dhe burime më të mira, të nevojshme jo vetëm për të mbijetuar por edhe për të treguar sukses.

Për më tepër, duhet të theksohet se shkalla e varfërisë është më e lartë tek individët me nevoja të veçanta, ku një e treta prej tyre jetojnë në varfëri.⁸ Këto shkallë të larta të varfërisë janë të ndërlidhura me mundësitë e kufizuara për arsimim cilësor dhe pastaj punësimin. Mungesa e infrastrukturës së duhur shkollore, diskriminimi dhe stigma janë disa prej faktorëve që ndikojnë në mundësitë e tyre për arsimim dhe punësim në të ardhmen. Kategoria e dytë dhe e tretë më e varfër, sipas këtij raporti, janë: të papunët (28.3%) dhe nxënësit/studentët (22.8%). Megjithatë, kur këta ndahen sipas etnisë, tek komunitetet rom, ashkali dhe egjiptianë varfëria është më e larta, me të ardhura mesatare prej 120 euro në muaj, ose 2 euro për të rritur në ditë.⁹ Po ashtu, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptianë, që përbëjnë më pak se 2% të popullsisë, ballafaqohen me sfida të shumta, si përjashtimi social, diskriminimi, mungesa e qasjes në shërbime sociale, punësimi, shëndetësia dhe strehimi. Në këtë kuptim, kur është fjala tek përfshirja sociale, ata konsiderohen grupi më i cenusshëm në shoqërinë e Kosovës.

Përfundimisht, cenusshmëria ekonomike e ndërlidhur me nivelet e larta të papunësisë në Kosovë (ndër faktorët e tjerë) ndikon në jetën dhe mirëqenien e të gjithë qytetarëve, por pakicat etnike, në veçanti komunitetet rom, ashkali dhe egjiptianë, të moshuarit, personat me nevoja të veçanta dhe të papunët konsiderohen kategoritë më të cenusshme dhe më të prirura për të qenë në nivele më të larta të varfërisë.¹⁰

7 Si më lart.

8 Qehaja L.: Zbatimi I Strategjisë Sektoriale të MPMS-së në vitin 2018 dhe 2019 – Raport i Vlerësimit Afatmesëm. Prishtinë, KEEN, nëntor 2019. http://www.kec-ks.org/wp-content/uploads/2020/08/Zbatimi-i-Strategjis%C3%AB-Sektoriale-t%C3%AB-MPMS_ENG-1.pdf

9 Analiza shumëdimensionale e varfërisë Kosovë 2017. Ambasada e Suedisë, Prishtinë 2017. <https://sidase-wp-files-prod.s3.eu-north-1.amazonaws.com/app/uploads/2020/12/01095837/kosovo-mdpa.pdf>

10 Si më lart.



2. Barazia në arsim

Kosova mori pjesë për herë të dytë në PISA në vitin 2018, dhe dëshmoi edhe një herë se nxënësit 15-vjeçarë të Kosovës treguan ndër sukseset më të ulëta në të gjitha disiplinat e testimit. Në këtë kontekst, 15-vjeçari i Kosovës shënoi 353 pikë në lexim, 366 pikë në matematikë dhe 365 pikë në shkencë, krahasuar me një mesatare prej 487 pikësh në lexim, 489 në matematikë dhe 489 në shkencë në vendet e OECD-së.¹¹ Rezultatet e tilla tregojnë se nxënësit 15-vjeçarë të Kosovës janë përafërsisht 4 vjet prapa në të tri lëndët, krahasuar me moshatarët e tyre në vendet e OECD-së.

Në kuptim të ndikimit të statusit socio-ekonomik (SSE) në arritjet e nxënësve, rezultatet e PISA 2018 treguan se nxënësit që kanë status më të lartë socio-ekonomik performuan më mirë se sa nxënësit e disfavorizuar, për 40 pikë në lexim, që është më pak se sa diferenca mesatare në mes të këtyre grupeve në vendet e OECD-së (89 pikë).¹² Rezultate të ngjashme janë parë në pikët e matematikës dhe shkencave, duke lënë të nënkuptohet se statusi socio-ekonomik në Kosovë ka ndikim në arritjet e nxënësve.

PISA vlerëson statusin socio-ekonomik të nxënësve përmes indeksit të PISA-s për statutin ekonomik, social dhe kulturor (ESCS), i cili merr parasysh disa ndryshore që lidhen kryesisht me sfondin familjar të nxënësve, përfshirë profesionin e prindërve, nivelin e arsimit të tyre, numrin e shtëpive, numrin e librave dhe burimeve të cilat i kanë në shtëpi.¹³ Prej të gjithë këtyre faktorëve, për nxënësit në Kosovë, PISA 2015 dhe 2018 vlerësuan dhe përdorën si ndryshore për të matur SSE-në vetëm arsimimin e prindërve dhe gjërat shtëpiake. Kështu, siç kuptohet dhe pritet në përgjithësi, niveli i arsimimit të prindërve luan rol të rëndësishëm në arritjet e nxënësve. Pra, rezultatet e PISA 2018 tregojnë se arritja e nxënësve rritet me rritjen

11 “Kosovo Country Note” – Rezultatet e PISA 2018. OECD, 2019. http://www.oecd.org/pisa/publications/PISA2018_CN_KSV.pdf

12 Si më lart.

13 OECD (2016), Rezultatet e PISA 2015 (Vëllimi I): Përsosmëria dhe barazia në arsim, PISA, botim i OECD, Paris. <http://dx.doi.org/10.1787/9789264266490-en>



e arsimimit të nënave me një diferencë prej 43 pikësh në lexim, 32 pikë në matematikë dhe 28 pikë në shkencë. Ngjashëm, rezultatet e arsimimit të baballarëve tregojnë diferencë në lexim për 83 pikë, në matematikë për 62 pikë dhe në shkencë për 62 pikë.

Për më tepër, siç u përmend më lart, gjërat në shtëpi janë një faktor tjetër matës i statusit socio-ekonomik dhe **Tabela 1** më poshtë paraqet pikët e PISA-s për nxënësit e Kosovës në matematikë sipas gjërave në shtëpi. Që këtej, nxënësit që nuk kishin qasje në internet treguan rezultat më të ulët (327) krahasuar me ata që kishin qasje në internet (371). Njësoj, nxënësit treguan rezultat më të dobët kur nuk kishin një vend të qetë për të studiuar (356), kur nuk kishin tavolinë pune (347) dhe kompjuter (355).

Tabela 1. Pikët në matematikë sipas gjërave në shtëpi

Gjërat në shtëpi	Ndryshoret (variablat)	Pikët në matematikë
Dhomën e vet	Po	367
	Jo	382
Internet	Po	371
	Jo	327
Vend të qetë për të studiuar	Po	369
	Jo	356
Tavolinë pune	Po	376
	Jo	347
Kompjuter	Po	371
	Jo	355
Telefon me qasje në internet në shtëpi	Po, e përdor Po, nuk e përdor Jo	N/A
Numri i kompjuterëve në shtëpi	Asnjë Një Dy Tre ose më shumë	N/A

Faktorët e sipërpërmendur të gjërave në shtëpi patën ndikim të ngjashëm në pikët e leximit dhe të shkencës, ku nxënësit që nuk kishin lidhje të internetit në shtëpi ose gjëra të tjera në shtëpi treguan sukses më të ulët se sa nxënësit që i posedonin ato. Në të njëjtën linjë, ekziston një konsensus i gjerë në mesin e pjesëmarrësve të këtij hulumtimi që statusi socio-ekonomik ndikon në rezultatet e nxënësve. Në këtë drejtim, është dëshmuar se statusi socio-ekonomik jo vetëm që ndikon në cilësinë e jetës, por edhe në mundësitë dhe privilegjet për të ardhmen.





Nxënësit me SSE të ulët gjatë COVID-19

Pandemia COVID-19, sikurse në shumë vende të botës, ka dëmtuar sistemin arsimor, derisa ka detyruar Qeverinë e Kosovës që të mbyllë përkohësisht të gjitha institucionet arsimore, në përpjekje për të kontrolluar përhapjen e virusit. Që këtej, Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH), në bashkëpunim me palët e tjera të interesit në arsim, përfshirë drejtoritë komunale të arsimit (DKA), organizatat jo-qeveritare (OJQ-të) dhe industrinë e TI-së mori masat e nevojshme për të organizuar mësimin në distance, i cili përfshinte një prezantim të regjistrimeve me video, të cilat transmetoheshin në televizionin kombëtar, zhvillimin e platformave online dhe përdorimin e mjeteve digjitale (Klasat në Google, ZOOM, viber, dhe rrjete të tjera sociale).

COVID-19 ka thelluar pabarazitë ekzistuese, duke i goditur më së shumti të varfrit dhe komunitetet më të cenueshme. Në këtë kontekst, pandemia ka vënë në pah pabarazitë edhe në sistemin arsimor. Organizimi i mësim-it në distancë ka përkeqësuar pabarazinë para-ekzistuese në arsim duke i zvogëluar mundësitë e grupeve të cenueshme në Kosovë (fëmijët me status të ulët socio-ekonomik, fëmijët/nxënësit e komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptianë, dhe fëmijët me nevoja të veçanta arsimore) për të vazhduar me të nxënit e tyre. Përkundër faktit që në nivel kombëtar nuk ka të dhëna zyrtare për pjesëmarrjen e nxënësve në mësimin në distancë, vlerësohet se rreth 32,000 nxënës nuk kanë pasur qasje në të nxënit nga distanca për shkak të mungesës së pajisjeve teknologjike, si dhe qasjes së kufizuar në internet. Kjo si pasojë ka thelluar hendekun e të nxënit në mes të fëmijëve me SSE të ulët dhe atyre nga familje me të ardhura më të larta, gjë që do të bëhet edhe më e theksuar me të përfunduar pandemia dhe me t'u kthyer fëmijët në mësim të rregullt.

Fëmijët/nxënësit nga grupet e cenueshme/të pafavorizuara kanë mungesë qasjeje në elementet kryesore të arsimit cilësor, përfshirë nevojat bazike për material shkollor, veshje, pajisje teknologjike, angazhim prindëror etj. Kështu, përfaqësuesit e MASH-it kanë argumentuar se kombinimi i të gjithë këtyre faktorëve shkakton stres tek këta fëmijë dhe ndikon në marrëdhënien e tyre me shokët dhe shkollën në përgjithësi, gjë që pastaj ndikon në sjelljen dhe rezultatet e tyre në shkollë. Të njëjtin këndvështrim kishin përfaqësuesit e DKA-ve dhe pjesëmarrësit në fokus grupe të cilët treguan se nxënësit me status të ulët socio-ekonomik nuk kanë mjedis të përshtatshëm shtëpiak, veshje, material shkollor dhe pajisje elektronike, të cilat i bëjnë të ndihen ndryshe prej shokëve të tyre, dhe përveç faktorëve

të tjerë ndikojnë edhe në përfshirjen e tyre në shkollë dhe në suksesin e tyre akademik në shkollë. Në anën tjetër, nxënësit që vijnë nga familje me status më të lartë socio-ekonomik kanë mjedis më të mirë në shtëpi dhe mbështetje në shtëpi për të inkurajuar zhvillimin e tyre social dhe akademik.

Një çështje tjetër që u ngrit gjatë gjithë diskutimeve me palë interesi ishte që fëmijët me SSE të ulët, për shkak të vështirësive të tyre financiare në familje, nuk janë të përfshirë në aktivitete jashtë-kurrikulare (p.sh. mësim/orë private në matematikë, gjuhë angleze, sport, lexim etj.) krahasuar me shokët e tyre, gjë që thëllon edhe më shumë dallimet e tyre në aspektin e zhvillimit, vetëbesimit dhe arritjes akademike.

Përveç kësaj, shumica e pjesëmarrësve në këtë hulumtim argumentuan se jeta për familjet me të ardhura të ulëta është shumë e vështirë dhe shpesh vështirësitë ekonomike i detyrojnë ata të marrin vendime në bazë të nevojës për të mbijetuar më shumë se sa për t'u zhvilluar në arsimim. Në këtë kuptim, mësimdhënësit dhe drejtorët e shkollave theksuan se në të shumtën e rasteve të braktisjes së shkollës, fëmijët detyroheshin të punojnë dhe të gjejnë mënyra të tjera për të mbështetur familjet e tyre, gjë që ka shpjerë në shkallë më të ulët të pjesëmarrjes dhe rezultateve në shkollë. Për më tej, ata shtuan se familjet që përfitojnë nga skemat e asistencës sociale, për arsye të ndryshme (mungesa e arsimimit bazë dhe nevoja për të mbijetuar dhe për të gjetur mjete të ndryshme për të mbështetur familjet e tyre), nuk përfshihen në çështjet që kanë të bëjnë me arsimimin e fëmijëve të tyre. Në anën tjetër, përfshirja e prindërve, si në shtëpi dhe në shkollë, është shumë e rëndësishme për rezultatet e të nxënësve.

Nga sa u tha më sipër, mund të nxirret si përfundim se vështirësitë ekonomike të shoqëruara me mungesë të mjedisit të përshtatshëm në shtëpi, materialit shkollor, veshjeve, pajisjeve teknologjike, dhe përfshirjes së prindërve janë disa prej sfidave për fëmijët me SSE të ulët, të cilat pengojnë pjesëmarrjen dhe arritjet në arsimin parauniversitar. Po ashtu, duhet të theksohet se dallimet e tilla fillojnë në moshë shumë të hershme dhe si pasojë, fëmijët/nxënësit me status të ulët socio-ekonomik janë veçse prapa krahasuar me moshatarët e tyre në secilin nivel të arsimit.



3. Politikat ekzistuese që kanë synim zvogëlimin e pabarazisë

3.1. Sistemi arsimor në Kosovë

E drejta për arsimim dhe zhvillim të potencialit të plotë të një fëmije është një prej të drejtave themelore dhe si e tillë garantohet me Kushtetutën e Kosovës, sipas së cilës secili individ ka të drejtë për arsimim sipas nevojave dhe aftësive të tij/saj.¹⁴ Po ashtu, sa i përket arsimit, korniza ligjore e Kosovës parasheh dhe mbështet një qasje gjithëpërfshirëse, e cila nënkupton që të gjitha ligjet që kanë të bëjnë me sektorin e arsimit parauniversitar në Kosovë përfshijnë udhëzime të veçanta për luftimin e braktisjes së shkollimit të obligueshëm në Kosovë dhe sigurimin e qasjes së barabartë në arsim pa marrë parasysh etninë, gjininë, racën, statusin ekonomik etj.

Sistemi arsimor para-universitar në Kosovë është i organizuar në bazë të Standardit Ndërkombëtar për Klasifikimin e Arsimit (ISCED), dhe përbëhet prej katër (4) niveleve të mëposhtme:


- ▶ Arsimi parashkollor (ISCED 0, mosha 0-5 vjeç),
- ▶ Arsimi fillor (ISCED 1, klasat 1-5, mosha 6-10 vjeç),
- ▶ Arsimi i mesëm i ulët (ISCED 2, klasat 6-9, mosha 11-14 vjeç),
- ▶ Arsimi i mesëm i lartë (ISCED 3, klasat 10-12, mosha 15-18 vjeç).

Struktura e përgjithshme e sistemit arsimor në Kosovë është ilustruar në Figurën 2 në vijim:

14 Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Kosovë, 2008. <https://gzk.rks-gov.net/Act-Detail.aspx?ActID=3702>



Figura 2. Struktura e përgjithshme e sistemit arsimor në Kosovë (përshtatur nga Butler et al. 2009 dhe përditësuar në vitin 2015)



Edukimi parashkollor organizohet në institucione parashkollore të specializuara dhe përfshin fëmijët e moshës 0 deri 5 vjeç. Ky nivel i arsimit karakterizohet me shkallë shumë të ulët të pjesëmarrjes, kryesisht për shkak të kapaciteteve të kufizuara për pranim, të cilat vijnë si pasojë e numrit të vogël të institucioneve parashkollore publike. Përveç kësaj, niveli parafillor (klasa 0), është një program përgatitor i cili ofrohet në institucione parashkollore dhe në shumicën e shkollave fillore në Kosovë.


Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët (klasat 1-9) janë të obligueshëm dhe përfshijnë pesë (5) vjet arsim fillor (klasa 1 deri 5) dhe katër (4) vjet



arsim i mesëm i ulët (klasat 6 deri 9). Me të përfunduar klasën e 9^{të}, nxënësit mund të zgjedhin për të vazhduar arsimin e mesëm të lartë (klasat 10-12), i cili përfshin dy nivele: arsimi i mesëm i përgjithshëm (gjimnazet) dhe arsimi dhe aftësimi profesional. Shkollimi zgjat tre (3) vjet dhe më ta përfunduar atë nxënësit mund të hyjnë në provimin e maturës, nëse dëshirojnë të ndjekin arsimin terciar. Në përgjithësi, pjesëmarrja e fëmijëve në të gjitha nivelet e arsimit, në veçanti në arsimin e obligueshëm është shumë e kënaqshme, me një shkallë regjistrimi bruto prej 95.7%.¹⁵

Në nivel të qeverisjes, ofrimi i arsimit parauniversitar decentralizohet dhe i ndan përgjegjësitë me qeverisjen qendrore (Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës - MASH), autoritetet lokale (Drejtoritë Komunale të Arsimit – DKA-të) dhe shkollat. Në këtë drejtim, MASH-i është përgjegjës për zhvillimin e politikave, standardeve kombëtare, monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë, ndërsa komunat janë përgjegjëse për infrastrukturën shkollore dhe mirëmbajtjen, rekrutimin e mësimitdhënësve, regjistrimin dhe pranimin e fëmijëve, punësimin e mësimitdhënësve, monitorimin e shkollave etj.¹⁶ Në nivel të shkollës, përveç drejtorit të shkollës, janë edhe tri organe qeverisëse që krijohen për të rritur transparencën dhe llogaridhënien, respektivisht këshilli drejtues i shkollës, këshilli i prindërve dhe këshilli i nxënësve. Funkionimi dhe krijimi i këtyre organeve rregullohet me ligj.

Figura 3. Organet qeverisëse në arsim



15 Statistikat e Arsimit në Kosovë 2019/2020. Agjencia e Statistikave të Kosovës, qershor 2020. <https://ask.rks-gov.net/en/kosovo-agency-of-statistics/add-news/education-statistics-in-kosovo-20192020>

16 Ligji Nr.03/L-068 për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës. Kosovë, 2008. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2543>

Financimi i sistemit arsimor në Kosovë bëhet përmes Buxhetit Qendror, i cili transferohet në komuna përmes një granti që quhet “Granti specifik për arsim”. Shuma e këtij granti përcaktohet me formulën e cila merr parasysh numrin e mësimdhënësve dhe regjistrimin e nxënësve. Po ashtu, kjo formulë merr parasysh edhe kurrikulat kombëtare, madhësinë e klasës; nevojat e veçanta për arsim, lokacionin dhe shpenzimet operative.¹⁷ Sido që të jetë, aktualisht formula e njëjtë e financimit aplikohet tek të gjitha shkollat dhe nuk merr parasysh nevojat e veçanta të shkollave (p.sh. fëmijët me nevoja të veçanta në arsim, shkollat profesionale, shkollat në të cilat vijojnë mësimin pakicat etnike etj.). Financimi i arsimit parauniversitar në Kosovë paraqet një prej sfidave kryesore në fushën e menaxhimit të arsimit. Edhe pse shpenzimet në arsim janë rritur ndër vite, Kosova vazhdon të mbetet një prej vendeve me shpenzimet më të ulëta për nxënës. Për më tepër, shpenzimi në arsim karakterizohet me mungesë të menaxhimit efikas, ku pjesa më e madhe e shpenzimeve përqendrohet në investime kapitale si dhe paga dhe shtesa, dhe më pak në burime që do të përmirësonin drejtpërdrejt të nxënësve dhe mësimdhënien.

Në nivel vendi, Korniza Kurrikulare për Arsimin Parauniversitar në Kosovë (KKK)¹⁸ bashkë me kurrikulat bërthamë për secilin nivel të ISCED përgatitet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bashkëpunim të ngushtë me palët e tjera të interesit në arsim, përfshirë këtu drejtoritë komunale të arsimit, shkollat, OJQ-të, ekspertët e arsimit dhe partnerët zhvillimorë. Ndërsa institucionet arsimore, si ato që janë të financuara publikisht ashtu edhe ato private, e kanë autonominë për të zhvilluar kurrikulat e tyre të bazuara në shkollë si dhe planprogramet e lëndëve, mirëpo nuk mund të devijojnë nga kurrikula bërthamë e zhvilluar në nivel kombëtar.¹⁹ Megjithatë, në praktikë për shkak të mungesës së kapaciteteve në nivel shkolle (institucionet arsimore publike), si kurrikula e bazuar në shkollë ashtu edhe planprogrami mësimor përgatiten nga Ministria. Po ashtu, përdorimi i teksteve shkollore në shkollat publike kufizohet në ato tekste që aprovohen nga Ministria, mirëpo shkollat dhe mësimdhënësit lejohen që të përdorin ose të gjejnë materiale të tjera mësimore plotësuese si dhe metoda të tjera të mësimdhënies.

17 Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal. Kosovë, 2008. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2525>

18 MASH, “Korniza kurrikulare e Arsimit Parauniversitar në Kosovë (e rishikuar),” 2016 (në Shqip). <https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/03/korniza-kurrikulare-finale.pdf>.

19 Ligji Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës. Kosovë, 2011. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2770>



3.1.1. Masat për të zvogëluar pabarazitë në arsim

Kur bëhet fjalë për barazinë në arsim, sipas legjislacionit, Kosova zbaton një sërë masash për të arritur rezultate të paanshme. Në këtë drejtim, ajo ofron tekste shkollore falas për të gjithë fëmijët që regjistrohen në arsimin e obligueshëm, parasheh ofrimin dhe organizimin e transportit falas dhe të përshtatshëm për të gjithë fëmijët që jetojnë brenda katër (4) km distancë nga shkolla, parasheh ofrimin e arsimit parashkollor falas për fëmijët nga grupet e cenushme, përfshirë fëmijët nga familjet në asistencë sociale, fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, fëmijët pa kujdes prindëror, fëmijët e veteranëve të luftës.

Për më tepër, për të mbështetur fëmijët me SSE të ulët, komunat përmes drejtorive të tyre të arsimit, zyrës për komunitete dhe kthim dhe drejtorive për shëndetësi dhe mirëqenie sociale identifikojnë nxënësit me SSE të ulët dhe në bashkëpunim me partnerët zhvillimorë (donatorët) ofrojnë mjete të nevojshme dhe materiale didaktike për shkollat. Disa komuna po ashtu ofrojnë bursa për nxënësit me SSE të ulët që regjistrohen në arsimin e mesëm të lartë, ndërsa MASH-i në bashkëpunim me partnerët zhvillimorë çdo vit ofron rreth 400 bursa në një vlerë prej 30 euro në muaj, të disejuara veçanërisht për nxënësit nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptianë të regjistruar në arsimin e mesëm të lartë.

Legjislacioni po ashtu parasheh organizimin e orëve plotësuese në nivel shkolle për të përkrahur fëmijët në përmirësimin e performancës së tyre akademike. Një praktikë tjetër e mirë në Kosovë e cila ka për qëllim që t'u ndihmojë fëmijëve me sukses të ulët dhe grupeve të tjera të cenushme, në veçanti fëmijëve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, janë Qendrat Mësimore, të cilat janë themeluar dhe deri vonë janë menaxhuar nga OJQ të ndryshme me mbështetjen e donatorëve ndërkombëtarë. Qendrat Mësimore, të cilat mund të jenë të bazuara në komunitete ose të bazuara në shkollë ofrojnë mbështetje në mësimin plotësues dhe organizojnë aktivitete të ndryshme arsimore për fëmijët në nevojë, përfshirë programe parashkollore për moshën 3 deri 5 vjeç, orë mësimore shtesë, u ndihmojnë fëmijëve me detyrat e shtëpisë, si dhe organizojnë aktivitete të ndryshme sociale. Një hap pozitiv së fundi, që u lavdërua edhe nga pjesëmarrësit në këtë hulumtim, ishte përgatitja dhe miratimi i UA Nr. 19/2018 për Themelimin dhe Funksonimin e Qendrave Mësi-



more,²⁰ i cili e njih punën e Qendrave Mësimore në përmirësimin e performancës akademike të nxënësve dhe vijueshmërisë në shkollë, që këtej rregullon procesin e krijimit, menaxhimit dhe financimit të qëndrueshëm.

Në të njëjtën linjë, me qëllim të luftimit të braktisjes së shkollës, janë krijuar Ekipet për parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obligueshëm (EPRBM) në nivel kombëtar, lokal dhe të shkollës. Krijimi dhe funksionimi i këtyre ekipeve rregullohet me UA Nr. 08/2018²¹, sipas të cilit përbërja e ekipeve në nivel të shkollës përbëhet prej menaxhmentit të shkollës, përfaqësuesve të prindërve dhe nxënësve, ndërsa në nivel të komunës përveç prindërve dhe nxënësve, ato po ashtu përfshijnë përfaqësuesit e drejtoratit komunal të arsimit, departamentit të shëndetësisë dhe mirëqenies sociale. Në nivel kombëtar ekipet e EPRBM përbëhen prej përfaqësuesve të MASH-it, MPMS-së, MSH-së, DKA-ve, shkollave, dhe grupeve të tjera të interesit. Roli i këtyre ekipeve është që të parandalojnë rastet e braktisjes dhe mosregjistrimit në institucione arsimore si dhe të bashkëpunojnë me institucionet përkatëse, OJQ-të dhe palët e tjera të interesit. Çfarë është shumë e rëndësishme dhe që pranohet nga pjesëmarrësit në këtë hulumtim është zhvillimi i modulit të veçantë të Sistemit për paralajmërim të hershëm (SPH) në Sistemin e Menaxhimit të Informatave në Arsim (SMIA), i cili përdoret për të nxjerrë informata për rastet që janë në rrezik të braktisjes së shkollës dhe për t'i sinkronizuar informatat e shkollave, DKA-ve dhe MASH-it.

Në përgjithësi, politika arsimore synon të planifikohet në mënyrë strategjike, që nënkupton që çdo pesë vjet, palët e interesit në arsim, përfshirë MASH-in, DKA-të, shkollat, OJQ-të dhe ekspertët e arsimit, vlerësojnë zbatimin e planit të mëparshëm strategjik, identifikojnë sfidat dhe mundësitë dhe planifikojnë fushat për zhvillimin e arsimit në pesë vitet e ardhshme. Aktualisht, ky dokument në fuqi është “Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017 – 2021”, ndërsa gjatë vitit 2021 politikëbërësit do të iniciojnë procesin e zhvillimit të planit të ri strategjik për periudhën 2022 – 2027. Megjithatë, ekziston një

20 Udhëzimi Administrativ Nr. 19/2018 për themelimin dhe funksionimin e Qendrave Mësimore <https://masht.rks-gov.net/uploads/2018/12/ua-nr-19-masht-per-themelimin-dhe-funksionimin-e-qendrave-mesimore-x.pdf>

21 Udhëzimi Administrativ Nr. 08/2018 për krijimin dhe fuqizimin e ekipeve për parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të nxënësve në arsimin e obligueshëm. MASH, 2018. <https://masht.rks-gov.net/uploads/2018/06/8-ua-masht-nr-08-2018-per-themelimin-dhe-fuqizimin-e-ekipeve-parandalim-dhe-kbmnapu.pdf>





konsensus i përgjithshëm në mesin e palëve të interesit arsimorë që kanë marrë pjesë në këtë hulumtim se midis zhvillimit të politikave dhe zbatimit të tyre ekziston një boshllëk, që nënkupton se Kosova ka kornizë të mirë ligjore, veçanërisht kur bëhet fjalë për sigurimin e barazisë, drejtësisë dhe gjithëpërfshirjes në arsim, por ka mungesë zbatimi të saj në praktikë, kryesisht për shkak të kapaciteteve të kufizuara financiare dhe njerëzore në nivel lokal dhe në nivel shkolle: *“Kosova ka kornizë ligjore shumë të avancuar, por fatkeqësisht ajo nuk zbatohet si duhet, që nënkupton se përpjekjet për përmirësimin e cilësisë dhe gjithëpërfshirjes në arsim mbeten vetëm në letër.”*²² Krahas këtij arsytimi, u konsiderua po ashtu se mekanizmat e monitorimit nuk janë të mjaftueshëm. Ministria e Arsimit dhe Shkencës përmes Inspektoratit të saj të arsimit është përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të politikave në nivel lokal dhe në nivel shkolle, megjithatë ata kanë kapacitete njerëzore të kufizuara për t’i bartur të gjitha përgjegjësitë që i jepen me Ligjin për Inspektoratin e Arsimit (d.m.th, vlerësimi i performancës së mësimdhënësve, vlerësimi i shkollës, vlerësimi administrativ etj.), gjë që shpesh rezulton në vlerësime sipërfaqësore më shumë se sa konstruktive. Mungesa e mekanizmave monitorues në nivel kombëtar dhe lokal pengon më tej vijën e llogaridhënies dhe të transparencës, të cilat ndikojnë edhe në zbatimin e politikave.

3.2. Sistemi i kujdesit shëndetësor

Në përgjithësi, përgjegjësia e Ministrisë së Shëndetësisë është që të ofrojë kujdes shëndetësor në Kosovë dhe ta mbikëqyrë atë, ndërsa Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik (IKSHP) është përgjegjës për organizimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e politikave të shëndetit publik në Kosovë.²³ Në mes detyrash tjera, IKSHP-ja është po ashtu përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e Programit për Imunizim, ndërsa në nivel komunal planifikimi, menaxhimi dhe monitorimi i programeve të imunizimit është përgjegjësi e Drejtorive Komunale të Shëndetësisë, të cilat në koordinim me Drejtoritë Komunale të Arsimit dhe shkollat e kryejnë procesin e vaksinimit të nxënësve në shkolla.

Në përputhje me Programin për Imunizim dhe dokumentet e tjera strategjike, Ministria e Shëndetësisë ka përgatitur edhe Planin

22 Fokus grupi me OJQ dhe ekspertë të arsimit mbajtur më 22 dhjetor, Prishtinë, Kosovë.

23 Ligji Nr. 04/L-125 për Shëndetësinë. Kosovë, maj 2013. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8666>

Strategjik për Imunizim 2019 - 2021 i cili ka për qëllim që të vendosë mënyrat për imunizimin e gjithë popullsisë së Kosovës. Sipas këtij plani, Kosova konsiderohet të jetë shumë e suksesshme në programin e imunizimit me shkallë vaksinimi prej 95%. Sfidë këtu paraqet shkalla e ulët e vaksinimit tek fëmijët nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptianë. Për të arritur imunizimin e gjithë popullsisë, autoritetet përkatëse ofrojnë qasje të barabartë në shërbime të vaksinimit si dhe organizojnë fushata të ndryshme për rritjen e vetëdijesimit mbi rëndësinë e imunizimit dhe të vaksinimit. IKSHP-ja bën monitorimin dhe raportimin e të dhënave.

Për më tepër, Ligji për Shëndetësinë²⁴ është në mes tjerash i bazuar në parimet e barazisë, gjithëpërfshirjes dhe mosdiskriminimit. Në këtë mënyrë, ai thekson në mënyrë specifike se të gjithë qytetarët e Kosovës kanë qasje të plotë në shërbime të kujdesit shëndetësor, përfshirë qasjen e lehtë në objektet e kujdesit shëndetësor për personat me aftësi të kufizuara dhe lirim nga pagesa të familjeve me të ardhura nën kufirin zyrtar të cenueshmërisë sociale, siç përcaktohet nga Qeveria.²⁵ Që këtej, kriteri i vetëm i pranueshmërisë për të pasur qasje në shërbime të kujdesit shëndetësor është të jesh i regjistruar si qytetar i Kosovës. E drejta për kujdes shëndetësor u jepet po ashtu individëve që janë të kualifikuar për statusin e refugjatit dhe personave nën mbrojtje plotësuese.²⁶

Shërbimet e kujdesit shëndetësor në Kosovë ofrohen nga një rrjet institucionesh të kujdesit shëndetësor të organizuara në tri nivele: shërbimi primar, sekondar dhe terciar. Funksonimi i këtyre shërbimeve të kujdesit shëndetësor publik financohet nga buxheti i Kosovës, fondet jashtëbuxhetore të donatorëve si dhe kontributi i bashkëpjesëmarrjes së pacientëve për shërbime dhe produkte të kujdesit shëndetësor, e cila është e rregulluar me një udhëzim të veçantë administrativ, UA 04/2007 për mbledhjen dhe shfrytëzimin e mjeteve nga bashkëpagesat e shfrytëzuesve të shërbimeve shëndetësore dhe të hyrave vetanake të institucioneve shëndetësore.²⁷ Në aspektin e mbështetjes së kujdesit shëndetësor për fëmijët me SSE të ulët, Ligji për Shëndetësi dhe UA 04/2007 përcaktojnë që për

24 Si më lart.

25 Si më lart.

26 Ligji Nr.06/L-026 për Azilin. Kosovë, maj 2018. <https://www.refworld.org/pdfid/5bf2ac0b4.pdf>

27 Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2007 për mbledhjen dhe shfrytëzimin e mjeteve (në shëndetësi) nga bashkëpagesat e shfrytëzuesve të shërbimeve shëndetësore dhe të hyrat vetanake të institucioneve shëndetësore. Kosovë, 2007. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7510>





grupet e veçanta të individëve shërbimet e kujdesit shëndetësor të ofrohen falas në institucionet e shëndetit publik. Këto grupe, ndër kategoritë e tjera, përfshijnë edhe individët me të ardhura më të vogla se sa pragu zyrtar i cënueshmërisë sociale, siç përcaktohet nga Qeveria, si dhe individët e regjistruar si të cënueshëm në aspektin social, në bazë të aktit nënligjor të lëshuar nga MPMS-ja.

Në këtë drejtim, grupet e cënueshme/të pafavorizuara në Kosovë duket se nuk përjashtohen nga qasja në shërbime shëndetësore, megjithatë e gjithë qasja në kujdesin shëndetësor karakterizohet me korrupsion, pritje të gjata, mungesë të mjekësisë esenciale që parashihet të ofrohet falas etj.; që nënkupton se grupet e cënueshme janë ato që i vuajnë më së shumti pasojat e këtij sistemi.

3.3. Sistemi i kujdesit dhe mirëqenies sociale

Ofrimi dhe zhvillimi i kujdesit social dhe shërbimeve familjare në Kosovë është nën përgjegjësinë e Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale (MPMS). Ndërsa, që nga 2009, si pjesë e reformës së përgjithshme të decentralizimit në vend, komunat u bënë autoriteti kryesor në ofrimin e shërbimeve sociale, dhe kështu autoriteti kryesor për të siguruar mbrojtje sociale dhe mirëqenie të qytetarëve të saj.²⁸ Sido që të jetë, decentralizimi i detyrave dhe përgjegjësisë nuk u shoqërua me decentralizimin financiar, që lë të nënkuptojë se komunat, në mënyrë specifike Drejtoritë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (DKSHMS) janë përgjegjëse për të planifikuar dhe për të zhvilluar shërbimet, ndërsa të gjitha shërbimet sociale dhe familjare vazhdojnë të financohen nga buxheti i shtetit.²⁹ Në këtë kontekst, DKSHMS ofron shërbime sociale dhe familjare përmes Qendrave për Punë Sociale (QPS), të cilat ofrojnë kujdes për të moshuarit, kujdes social dhe këshillim për fëmijët pa kujdes prindëror, fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët që vuajnë si pasojë e konfliktit në familje si dhe rastet e tjera sociale.³⁰

28 Kahlert R., Danaj S.: Decentralizimi i shërbimeve sociale në Kosovë – Sfidat dhe rekomandimet për politika. Qendra Evropiane për Politika të Mirëqenies Sociale dhe Hulumtim, Vjenë 2018. <https://www.euro.centre.org/publications/detail/3239>

29 Sandu V., Kahlert R.: Monitorimi dhe Vlerësimi i Shërbimeve Sociale në Kosovë – Ndryshimet dhe rekomandimet për politika. Kosovë, 2019. <https://kosovo.savethechildren.net/sites/kosovo.savethechildren.net/files/library/PolicyBrief-ENG.pdf>

30 Ligji Nr. 02/L-17 për shërbime sociale dhe familjare. Kosovë, 2007. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2447>

Skema e Asistencës Sociale (SAS) është programi kryesor i asistencës sociale në Kosovë dhe është programi i vetëm që përdor të hyrat dhe pasuritë e familjeve për të identifikuar përfituesit.³¹ Në këtë drejtim, Ligji për Skemën Sociale rregullon mbështetjen financiare për familjet e pranueshme, të cilat duhet t'i përkasin njëres prej këtyre dy kategorive të përcaktuara. Kategoria e parë përfshin familjet, ku të gjithë anëtarët e familjes janë të varur financiarisht, të papunë; ndërsa kategoria e dytë përfshin familjet, ku të gjithë anëtarët e familjes janë të papunë, por që kanë një anëtar të familjes në gjendje të punojë dhe së paku një fëmijë nën moshën pesë (5) vjeçare dhe/ose një jetim nën moshën 15 vjeçare, nën kujdes të plotë.³² Në këtë mënyrë, SAS përqendron burimet financiare tek familjet me fëmijë të vegjël dhe tek ato në të cilat të gjithë ose shumica e anëtarëve të familjes nuk janë në gjendje të punojnë. Asistenca sociale në këtë drejtim përcaktohet në bazë të pikëve të fituara, varësisht nga numri i anëtarëve të familjes dhe në bazë të kostos së shportës minimale të ushqimit.³³ Deri më tash, mbështetja financiare ndryshon nga 50 euro për familje me 1 anëtar deri në 150 euro për familjen me 15 anëtarë të familjes.³⁴

Skema e asistencës sociale është një skemë e zhvilluar për varfërinë, megjithatë shumica e ndihmës mujore është shumë e ulët dhe nuk është e mjaftueshme për ta nxjerrë një person ose një familje nga varfëria. Përveç kësaj, kriteret e ashpra ua vështirësojnë familjeve të tjera në nevojë, të cilat nuk i plotësojnë medoemos një prej këtyre dy kriterëve për asistencë sociale, që të përfitojnë nga kjo skemë. Në këtë drejtim, janë identifikuar tri probleme të mëdha me kriteret teknike dhe financiare: Fillimisht, kriteri i të pasurit një fëmijë nën moshën 5 vjeç, i cili i takon kategorisë 2, nuk mbështetet nga hulumtimet, meqë kosto e rritjes së një fëmije nuk zvogëlohet medoemos me të mbushur fëmija 5 vjet. Sipas këtij kriteri një familje në kategorinë e dytë diskualifikohet nga skema kur fëmija e arrin moshën 5 vjeç.³⁵ Kriteri i dytë, punësimi i një anëtari të familjes (madje edhe

31 Studimi i Skemës së asistencës sociale në Kosovë . Vlerësimi dhe opsionet për reformim. Banka Botërore, mars 2019. <http://documents1.worldbank.org/curated/en/994991557470271998/pdf/Kosovo-Social-Assistance-Scheme-Study-Assessment-and-Reform-Options.pdf>

32 Ligji Nr. 02/L-17 për shërbimet sociale dhe familjare. Kosovë, 2007. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2447>

33 Ligji Nr. 02/L-17 për shërbimet sociale dhe familjare. Kosovë, 2007. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2447>

34 Statistikat e mirëqenies sociale në Kosovë TM1. Agjencia e Statistikave e Kosovës, maj 2020. <https://ask.rks-gov.net/media/5508/social-welfare-statistics-q1-2020.pdf>

35 Studimi i Skemës së Asistencës Sociale. Vlerësimi dhe opsionet e reformës. Banka Botërore, mars 2019. <http://documents1.worldbank.org/curated/en/994991557470271998/pdf/Kosovo-Social-Assistance-Scheme-Study-Assessment-and-Reform-Options.pdf>





në rastin e punës afatshkurtër ose sezonale) shpie në diskualifikim të familjes nga skema e asistencës sociale, që më pas shërben si stimulim për individët që të punojnë në sektorin joformal; dhe kriteri i tretë, familjet nuk mund të përfitojnë nga asistenca sociale nëse kanë patundshmëri mbi 0.5 hektarë, përkundër faktit se ato nuk kanë të ardhura.³⁶

Sa i përket mbështetjes së fëmijëve, për çdo fëmijë nën moshën 18 vjeçare jepet një pagesë prej 5 euro në muaj.³⁷ Megjithatë, një transferim i tillë i parave kushtëzohet dhe varet nga vijueshmëria në shkollë. Kështu, të gjitha familjet/që përfitojnë nga skema e asistencës sociale duhet ta sigurojnë një dokument që lëshohet nga shkolla i cili konfirmon se fëmija është nxënës i rregullt. Përndryshe, në mungesë të këtij dokumenti familja e humb të drejtën për të marrë asistencë sociale.³⁸

Në përgjithësi, për shkak të reformës së decentralizimit, e cila barti përgjegjësinë e ofrimit të shërbimeve (arsimin, shëndetësinë, mirëqenien sociale, strehimin etj.) tek komunitet, drejtoritë komunale, në veçanti drejtoria e arsimit, drejtoria për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, zyra për komunitete dhe kthim dhe divizionet e tjera përkatëse janë përgjegjëse për të bashkëpunuar me njëra-tjetrën dhe në bazë të detyrave dhe përgjegjësi të tyre të informojnë, identifikojnë dhe referojnë rastet e nxënësve/familjeve në nevojë për shërbime të kujdesit social, shëndetësi dhe arsim. Bashkëpunimi ndër-sektorial është qenësor në ofrimin e arsimit cilësor, shërbimeve sociale dhe shëndetësore për të gjithë nxënësit në nevojë. Kështu, MASH-i, DKA-të dhe përfaqësuesit e shkollës që kanë marrë pjesë në këtë hulumtim konfirmuan se bashkëpunimi ndër-sektorial është i rregulluar dhe se çdo javë organizohen mbledhje formale në nivel komunal në mes të të gjitha drejtorive, për të diskutuar çështje të ndryshme dhe për të ndarë të dhëna dhe informata. Në aspektin e arsimimit të fëmijëve me SSE të ulët, në veçanti të rasteve të braktisjes së shkollës, ka bashkëpunim të ngushtë në mes të qendrave për punë sociale, shkollave dhe ofruesve të kujdesit shëndetësor.

-
- 36 Demi, A.: Politikat e punësimit dhe të mirëqenies sociale në Kosovë. Raporti vlerësues. KEEN, Prishtinë, dhjetor 2017. <http://www.kec-ks.org/wp-content/uploads/2020/08/Raport-vler%C3%ABsimi-p%C3%ABr-Politikat-e-Pun%C3%ABsimit-dhe-Mir%C3%ABqenies-Sociale-n%C3%AB-Kosov%C3%AB.pdf>
- 37 Studimi i Skemës së Asistencës Sociale në Kosovë. Vlerësimi dhe opsionet e reformës. Banka Botërore, mars 2019. <http://documents1.worldbank.org/curated/en/994991557470271998/pdf/Kosovo-Social-Assistance-Scheme-Study-Assessment-and-Reform-Options.pdf>
- 38 Intervistë grupore me përfaqësues të DKA-ve e mbajtur më 14 tetor 2020, Prishtinë, Kosovë.

4. Analiza e reformës në arsim dhe barazia

Në përgjithësi, mund të argumentohet se barazia në arsim është pjesë e agjendës së politikave në Kosovë, meqë ajo aktualisht zbaton një sërë masash që synojnë arritjen e rezultateve të paanshme. Fillimisht, siç edhe është sqaruar në seksionin e mëparshëm mbi sistemin arsimor, Kosova garanton të drejtën për shkollim të njëjtë për të gjithë nxënësit. Kjo theksohet si në Kushtetutë ashtu edhe në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Kosovë, sipas të cilave, arsimi i obligueshëm (klasa 1 deri 9) është falas për të gjithë nxënësit. Në të njëjtën mënyrë, me qëllim të zvogëlimit së barrës së kostos për prindërit dhe me qëllim të ofrimit të mundësive për të gjithë fëmijët që të shkojnë në shkollë, pa marrë parasysh sfondin e tyre socio-ekonomik, Kosova siguron tekste shkollore falas (përfshirë tekstet shkollore në gjuhën boshnjake dhe turke) për të gjithë fëmijët e regjistruar në arsimin e obligueshëm. Në anën tjetër, ofrimi i një shujte falas për të gjithë nxënësit është praktikë që mund të gjendet në disa komuna/shkolla të Kosovës, megjithatë ky nuk është gjithmonë rasti, meqë kjo varet edhe nga gatishmëria dhe menaxhmenti i komunave, të cilat, si pjesë e reformës së përgjithshme të decentralizimit në vend, janë përgjegjës për menaxhimin e arsimit parauniversitar.

Sipas legjisllacionit, komunat po ashtu duhet të ofrojnë dhe organizojnë transport falas, të sigurt dhe të përshtatshëm për fëmijët që jetojnë brenda katër (4) km distancë nga shkolla,³⁹ që zakonisht përfshin nxënësit që jetojnë në zonat rurale, të cilët pastaj ndërlidhen edhe me nivele më të larta të varfërisë. Përkundër faktit se përfaqësuesit e DKA-ve që kanë marrë pjesë në këtë hulumtim konfirmuan se komunat e tyre organizojnë transport të sigurt dhe të përshtatshëm për fëmijët sipas legjisllacionit, kjo nuk mund të konsiderohet si praktikë

39 Ligji Nr. 04/L-032 për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës. Kosovë, 2011. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2770>





e mirë e cila ndiqet nga të gjitha komunat e Kosovës. Në këtë drejtim, ekspertët e arsimit dhe përfaqësuesit e OSHC-ve theksuan se vetëm disa komuna organizojnë transport falas për nxënës, ndërsa një sfidë më e madhe mbetet sigurimi i transportit dhe i asistentëve mësimdhënës për fëmijët me nevoja të veçanta në arsim të regjistruar në shkolla të rregullta, gjë që ndikon drejtpërdrejt në përfshirjen e tyre në shkollë dhe në vijueshmëri të rregullt. Përkundër që legjislacioni parasheh ofrimin e masave të tilla kjo nuk zbatohet në praktikë, gjë që tregon një shembull tjetër të një politike që mbetet e mirë vetëm në letër.

Për më tej, sa i përket masave të kujdesit social që janë caktuar për të arritur barazi në arsimin parashkollor, fëmijët nga grupet e cenueshme, përfshirë fëmijët nga familjet që jetojnë me asistencë sociale, fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, fëmijët pa kujdes prindëror dhe fëmijët e veteranëve të luftës lirohen nga çdo pagesë. Në këtë pikë, komunat obligohen që të sigurojnë vend në institucionet parashkollore dhe të subvencionojnë fëmijët e liruar nga pagesa.⁴⁰ Fatkeqësisht, kjo përfaqëson një politikë tjetër të mirë e cila nuk zë vend në praktikë. Përfaqësuesit e OSHC-ve që janë të angazhuara në arsimimin e grupeve të cenueshme sqaruan se numri i vogël i fëmijëve me SSE të ulët të përfshirë në arsimin parashkollor tregon se shumë fëmijë nuk përfitojnë nga masat e tilla. Në një masë të madhe kjo mund t'i atribuohet mungesës së vetëdijesimit të familjeve me të ardhura të ulëta lidhur me këto masa. Megjithatë, si pengesë në përfshirjen e fëmijëve me SSE të ulët në arsimin parashkollor publik u përmendën edhe rastet e institucioneve parashkollore publike që për arsye të ndryshme nuk kanë zbatuar këto masa në përputhshmëri me ligjin (p.sh. numri i kufizuar i fëmijëve etj.).

Kur bëhet fjalë për mbështetjen e fëmijëve me SSE të ulët në përmirësimin e performancës akademike, të gjithë përfaqësuesit e shkollave që morën pjesë në intervistë grupore deklaruan se orët plotësuese organizohen për nxënës që kanë nevojë për përkrahje shtesë për të përmirësuar të nxënit e tyre. Në anën tjetër, edhe pse organizimi i orëve plotësuese kërkohet me ligj, përfaqësuesit e OSHC-ve theksuan se kjo praktikë nuk është e zakonshme në të gjitha shkollat e Kosovës, dhe kështu ajo varet shumë nga gatishmëria dhe motivimi i mësimdhënësve: *“Në përgjithësi, edhe pse organizimi i orëve plotësuese rregullohet me ligj, në shumicën e shkollave kjo nuk*

*kërkohet/mbikëqyret nga menaxhmenti i shkollës si dhe autoritetet komunale dhe qendrore përgjegjëse për monitorim.*⁴¹ Në këtë drejtim, mungesa e mekanizmave mbështetës dhe monitorues për të siguruar llogaridhënie ndikon në zbatimin e politikave në nivel të shkollës.

Një praktikë tjetër e mirë që synon të ndihmojë fëmijët me sukses të ulët dhe grupet e tjera të cënueshme janë të ashtuquajturat Qendrat Mësimore, të cilat janë themeluar dhe janë funksionale në komuna të ndryshme të Kosovës. Në këtë drejtim, në mesin e komunitetit arsimor është konsideruar dhe dakorduar se Qendrat Mësimore kanë luajtur një rol të rëndësishëm jo vetëm në përmirësimin e pjesëmarrjes së fëmijëve në të gjitha nivelet e arsimit, mirëpo edhe në performancën e tyre në shkollë. Sido që të jetë, deri vonë, Qendrat Mësimore kanë funksionuar nëpërmjet mbështetjes financiare të donatorëve, e cila nuk është e qëndrueshme. Siç u përmend në seksionin e mëparshëm, një hap pozitiv në këtë drejtim ishte hartimi dhe miratimi i Udhëzimit Administrativ Nr. 19/2018 për themelimin dhe funksionimin e qendrave mësimore⁴² i cili përcakton kriteret dhe procedurat për themelimin, funksionimin dhe financimin e Qendrave Mësimore. Edhe pse disa masa janë ndërmarrë drejt zbatimit të këtij akti nënligjor, autoritetet qendrore nuk kanë ndarë buxhet për masa të tilla, gjë që ndikon shumë në funksionimin e Qendrave Mësimore. Aktualisht, për shkak të mungesës së fondeve, shumë Qendra Mësimore nuk funksionojnë.

Për më tej, krijimi i Ekipeve për parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obligueshëm (EPRBM) në nivel kombëtar, lokal dhe të shkollës është një praktikë tjetër e mirë që u identifikua nga të gjithë pjesëmarrësit e këtij hulumtimi, e cila nëse zbatohet siç duhet mund të ketë ndikim të madh në zvogëlimin e rasteve të braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obligueshëm. Edhe pse krijimi dhe funksionimi i grupeve të tilla rregullohet me aktin nënligjor, ngjashëm si tek reformat e tjera, zbatimi i saj në praktikë mbetet pikëpyetje. Në këtë drejtim, ka një dallim në mes të përgjigjeve të pjesëmarrësve në fokus grupe lidhur me funksionimin e EPRBM-ve. Në njërin anë, përfaqësuesit e shkollave, DKA-ve dhe MASH-it që morën pjesë në këtë hulumtim u shprehën se këta mekanizma janë funksionalë dhe ia kanë dalë të zgjidhin me

41 Fokus grupi me OJQ-të dhe ekspertët e arsimit më 22 tetor, Prishtinë, Kosovë.

42 Udhëzimi Administrativ Nr. 19/2018 për themelimin dhe funksionimin e qendrave mësimore <https://masht.rks-gov.net/uploads/2018/12/ua-nr-19-masht-per-themelimin-dhe-funksionimin-e-qendrave-mesimore-x.pdf>





sukses shumë raste të braktisjes së shkollës. Ndërsa në anën tjetër, përfaqësuesit e OSHC-ve, në bazë të vizitave nëpër shkolla, të organizuara në emër të projekteve të tyre, argumentuan se grupet e tilla janë krijuar në shumë shkolla, por ato nuk janë funksionale në kuptim të përfshirjes së tyre dhe përmbushjes së detyrave dhe përgjegjësi që u caktohen me legjislacionin përkatës.

Po ashtu, financimi aktual i arsimit në bazë të numrit të nxënësve dhe mësimeve, pa marrë parasysh nevojat e tjera dhe specifikat e shkollës, paraqet një sfidë për shkollat që të zbatojnë si duhet politikën në nivel shkollor. Për shembull, shkollat profesionale kanë nevojë shtesë për blerjen e materialeve që do t'u mundësonin organizimin e mësimit praktik në shkollë. Ngjashëm, shkollat që ofrojnë shërbime për fëmijët me nevojë të veçanta arsimore, ato në të cilat vijojnë mësimin komunitetor kanë nevojë të tjera të cilat duhet të merren parasysh. Mbi këtë arsytim, kur u pyetën për masat që ndërmerren në nivel shkollor për të mbështetur fëmijët me SSE të ulët, përfaqësuesit e shkollës përmes intervistave të tyre u shprehën se *“mungesa e buxhetit dhe pamundësia për të menaxhuar buxhetin, kufizon mundësinë tonë për të organizuar aktivitete ose për të ndërmarrë masa për mbështetjen e fëmijëve me SSE të ulët (p.sh. organizimi i aktiviteteve ekstra-kurrikulare, mbështetja me materiale shkollore dhe nevojë të tjera)”*.⁴³ Si rezultat, shkollat përmes bordeve të tyre drejtuese mbledhin fonde prej prindërve vullnetarisht, të cilat pastaj u shpërndahen fëmijëve në nevojë, dhe me të cilat blihen materiale shkollore, ose mbulohen shpenzimet për aktivitete ekstra-kurrikulare (p.sh. ekskursionet e shkollës).⁴⁴

Çështjet e tjera sfiduese të identifikuara në këtë hulumtim janë mungesa e shërbimeve profesionale (psikologut dhe pedagogut) në nivel shkollor. Aktualisht, në të gjitha institucionet arsimore publike në Kosovë ka rreth 81 psikologë dhe 69 pedagogë. Në anën tjetër, shërbimet e tilla, në veçanti psikologët, janë shumë të rëndësishme për mbështetjen e aftësive të nxënësve për të mësuar, për të pasur sukses akademik, për aspektin social dhe emocional. Në këtë drejtim, në mesin e pjesëmarrësve të këtij hulumtimi është dakorduar se ofrimi i shërbimeve mbështetëse është i nevojshëm veçanërisht për fëmijët me SSE të ulët, për t'u ndihmuar që të përmirësojnë të

43 Intervistë e përbashkët me përfaqësuesit e shkollës e mbajtur më 15 tetor, Prishtinë, Kosovë.

44 Si më lart.

nxënit dhe për të arritur sukses akademik dhe emocional. Përveç kësaj, bashkëpunimi me prindër dhe përfshirja e tyre në procesin arsimor është po aq e rëndësishme në arritjen e qëllimeve arsimore të nxënësve. Në këtë drejtim, ka pasur konsensus në mesin e pjesëmarrësve se organet drejtuese të shkollës, respektivisht këshilli drejtues, këshilli i prindërve dhe nxënësve duhet të fuqizohen meqë sot në shumicën e shkollave, në veçanti në ato rurale, ata nuk janë funksionalë. Bashkëpunimi në mes të këtyre tri organeve është i rëndësishëm për mbështetjen e të gjithë fëmijëve, përfshirë ata me SSE të ulët. Po aq e rëndësishme në arritjen e rezultateve të barabarta është përmendur edhe roli i mësimitdhënësve në klasë dhe nevoja për përmirësim të vazhdueshëm të praktikave të mësimitdhënies përmes programeve për ZHPM për të njohur identitetet e nxënësve dhe metodat e ndryshme përmes së cilave mësojnë më së miri.

Në fund, është një pajtim i përgjithshëm në mes të palëve të interesit në arsim, respektivisht DKA-ve, MASH-it dhe shkollave, që përveç ofrimit të disa masave për mbështetjen e arsimimit të fëmijëve me SSE të ulët, si sigurimi i teksteve shkollore, materialeve shkollore falas, mbështetjes shtesë përmes orëve plotësuese dhe qendrave mësimore, fëmijët, në veçanti familjet me të ardhura të ulëta kanë nevojë për më shumë mbështetje financiare, për arsye se pagesa mujore që ofrohet në kuadër të skemës së asistencës sociale, nuk është e mjaftueshme për ta ndihmuar një familje që të dalë nga varfëria. Në këtë drejtim, është argumentuar se për të zbutur varfërinë është e domosdoshme rishikimi i skemave të asistencës sociale. Të gjeturat e tilla janë në përputhje me të gjeturat nga raporte të ndryshme që kanë vlerësuar Skemat e Asistencës Sociale në Kosovë.

Si përfundim, të gjitha palët e interesit në arsim që kanë marrë pjesë në këtë hulumtim konsiderojnë se Kosova ka një kornizë shumë të mirë ligjore e cila po ashtu synon të sigurojë barazi në arsim. Megjithatë, sfida mbetet zbatimi i politikave dhe standardeve në nivel komunal dhe të shkollës, i cili varet shumë nga gatishmëria dhe menaxhmenti i komunës dhe shkollës. Po ashtu, mungesa e mekanizma e mbështetës dhe monitorues pengojnë llogaridhënien, e cila pastaj është një prej faktorëve që ndikon në zbatimin e politikave.



5. Përfundimet kryesore dhe rekomandimet

Gjatë dekadës së fundit, Kosova ka kaluar nëpër reforma të mëdha në sistemin arsimor, përfshirë decentralizimin e sistemit të arsimit, zhvillimin e kornizës kurrikulare të bazuar në kompetencë, sigurimin e cilësisë, zhvillimin profesional të mësimeve dhe sistemin e licencimit, zgjerimin e përdorimit të TIK-ut, investimin në infrastrukturën shkollare etj. Të gjitha këto zhvillime janë bërë mbi parimet e barazisë dhe paanshmërisë, dhe duke ditur që ato janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën, zbatimi i tyre i duhur do të mund të kishte ndikim të madh jo vetëm në përmirësimin e cilësisë së arsimit, por edhe në arritjen e rezultateve të paanshme. Në këtë drejtim, diskutime të mëdha me palë të interesit në arsim kanë treguar se zbatimi i duhur i reformave arsimore në Kosovë kërkon fuqizimin e llogaridhënies, monitorimit dhe qasjeve të tjera mbështetëse dhe të vlerësimit që synojnë të përmirësojnë zbatueshmërinë dhe efektivitetin. Megjithatë, pa marrë parasysh kreativitetin në qasjet për llogaridhënie, zbatimi i reformave në arsim duhet të përkrahët me financim dhe burime të qëndrueshme. Lidhur me këtë, në vijim janë dhënë disa reflektime mbi hapat e ardhshëm, me qëllim të përmirësimit të barazisë në arsim:

- 1. Rishikimi i Skemës së Asistencës Sociale në Kosovë** - Skemat aktuale të asistencës sociale që e kanë cak varfërinë nuk janë të mjaftueshme për të ndihmuar që një familje të dalë nga varfëria, meqë shuma e pagesës mujore është shumë e ulët. Për më tepër, kriteret e ashpra ua vështirësojnë/pamundësojnë familjeve të tjera në nevojë, të cilat jo medoemos e përmbushin njërin prej dy kriterëve të asistencës sociale, që të përfitojnë nga kjo skemë. Më tej, kriteri për të pasur së paku një fëmijë nën moshën 5 vjeçare, i cili bie nën kategorinë 2, nuk mbështetet nga hulumtimet, pasi që shpenzimet për rritjen e një fëmije nuk zvogëlohen domosdoshmërisht me të mbushur fëmija pesë vjet. Me këtë dhe në bazë të diskutimeve me palët e interesit rekomandohet që Skemat e Asistencës



Sociale të cilat bien në kompetencën e MPMS-së duhet të rishikohen për të synuar zvogëlimin e varfërisë në Kosovë.

2. **Rishikimi i formulës së financimit në arsimin parauniversitar për të plotësuar nevojat e shkollës** – Financimi i arsimit parauniversitar në Kosovë paraqet një prej sfidave më të rëndësishme në fushën e menaxhimit të arsimit. Përveç shpenzimeve të ulëta për nxënës, shpenzimet në arsim karakterizohen me mungesë të menaxhimit efikas, ku pjesa më e madhe e shpenzimeve fokusohen në investime kapitale si dhe në paga e shtesa. Në këtë drejtim, financimi aktual i arsimit parauniversitar në Kosovë nuk i plotëson nevojat e shkollave për të bërë përmirësime të nevojshme si dhe për zbatimin e politikave/reformave në nivel të shkollës. Përveç kësaj, formula e njëjtë e financimit aplikohet tek të gjitha shkollat pa marrë parasysh nevojat e tyre. Prandaj, është e nevojshme që të rishikohet formula e financimit e arsimit parauniversitar, në mënyrë që të adresojë nevojat e shkollës, dhe e cila në veçanti duhet të marrë parasysh nevojat për financim më të madh të shkollave në të cilat vijnë mësimin komunitetet, fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, fëmijët me SSE të ulët etj. Qëllimi duhet të jetë që buxheti t'i përshtatet situatës infrastrukturore të shkollës për të ofruar mundësi të barabarta arsimore për fëmijët nga grupet e cenueshme të përmendura më lart. Po ashtu, investimi për nxënës në arsim duhet të rritet, në mënyrë që të përfshijë shpenzimet e tjera përtej pagave, si: bibliotekat, mjediset e jashtme, laboratorët e shkollës për mësim praktik, kompjuterët dhe organizimi i aktiviteteve të tjera jashtë-kurrikulare.
3. **Organizimi i orëve plotësuese dhe programeve të tjera këshilluese në nivel të shkollës** – Politikat, strategjitë dhe programet zhvillimore, përkundër përparësive të tyre, e humbin relevancën e tyre atëherë kur autoritetet përgjegjëse nuk kanë kapacitete dhe gatishmëri për t'i zbatuar. Është e qartë se statusi socio-ekonomik ndikon në përfshirjen dhe arritjet e nxënësve, prandaj komunat dhe në veçanti shkollat duhet të analizojnë demografinë e shkollës dhe t'i adresojnë nevojat nxënësve. Në këtë kuptim, menaxhmenti i shkollës duhet të kërkojë dhe të mbikëqyrë organizimin e orëve plotësuese sipas ligjit. Po ashtu, duke marrë parasysh se nxënësit që janë të lidhur me shkollën prirën të kenë sukses më të mirë akade-





mik si dhe në aspektin social, komuniteti i shkollës duhet të ndër marrë praktika të tjera mësimore bashkëpunuese ose programe këshillimi për të përmirësuar të nxëniti e nxënësve dhe gjithëpërfshirjen në shkollë. Përveç këtyre, rekomandohet që planet zhvillimore të shkollave duhet të përqendrohen në arsimimin e fëmijëve me SSE të ulët dhe ofrimin e formave të ndryshme të mbështetjes.


4. **Ofrimi i shërbimeve profesionale në nivel shkolle** – Psikologët dhe pedagogët përmes ofrimit të këshillimit dhe mbështetjes emocionale janë shumë të rëndësishëm në mbështetjen e aftësisë të nxënësve për të mësuar, për të pasur sukses akademik, në aspektin social dhe emocional. Ekspertiza e shërbimeve të tilla është e dobishme veçanërisht në adresimin e nevojave të nxënësve me SSE të ulët dhe nxënësve me nevoja të veçanta arsimore, duke ofruar mbështetje të vazhdueshme dhe duke siguruar që ata mund ta përballojnë procesin mësimor. Në këtë mënyrë, duke ditur numrin e vogël të psikologëve në shkolla, paraqitet nevoja jo vetëm për të rritur numrin e psikologëve në shkollë, por edhe për të investuar në zhvillimin e vazhdueshëm profesional të tyre si dhe në koordinimin dhe mbikëqyrjen e shërbimeve të tyre në bazë të roleve dhe përgjegjësisë të tyre.
5. **Rritja e angazhimit të prindërve** – Të dhënat kanë treguar se angazhimi prindëror është shumë i rëndësishëm në përvojën arsimore të nxënësit. Në anën tjetër, intervistat me shkolla dhe me OSHK kanë treguar se angazhimi prindëror në Kosovë nuk është i mjaftueshëm, se në shkallë të madhe i mëveshët faktit se prindërit nuk janë të vetëdijshëm për rolin e tyre qenësor në arsimin e fëmijëve të tyre. Po ashtu, pasiviteti i prindërve mund të vjen si pasojë e nivelit të ulët arsimor dhe të të ardhurave të ulëta si dhe orarit të gjatë të punës të prindërve. Prindërit duhet të informohen për të drejtat e tyre dhe të motivohen për të marrë pjesë aktive dhe për të kontribuar në përmirësimin e rezultateve shkollore. Përveç kësaj, paraqitet nevoja për të zhvilluar dhe organizuar programe trajnuese dhe aktivitete të tjera arsimore që mund t'i sjellin prindërit më afër shkollave dhe mund të rrisin komunikimin ndërmjet këtyre dy palëve.
6. **Ofrimi i programeve për Zhvillimin Profesional të Mësimdhënësve (ZHPM) në bazë të nevojave të mësimdhënësve** – Intervistat me palë interesi në arsim kanë treguar se mësimdhënësit luajnë një rol të rëndësishëm në angazhimin dhe re-

zultatet e të nxënit të nxënësve. Kështu, në mesin e pjesëmarrësve ka pasur dakordim të përgjithshëm se duhet të bëhen investime në ofrimin e vazhdueshëm të programeve për ZHPM për mësimdhënësit në bazë të nevojave të tyre. Derisa procesi i zhvillimit profesional të mësimdhënësve është i rregulluar dhe janë zhvilluar programe të ndryshme për gjithëpërfshirje dhe barazi në arsim, deri më sot ofrimi i trajnimeve bëhet në bazë të prioriteteve të qeverisë dhe të donatorëve, të cilat jo domosdoshmërisht janë në përputhje me nevojat e mësimdhënësve. Në këtë mënyrë, përkundër rritjes së buxhetit për aktivitetet e ZHPM-së në nivel qendror dhe lokal, është e domosdoshme që të bëhet një analizë e nevojave të mësimdhënësve në nivel kombëtar, dhe në bazë të demografisë dhe nevojave komunale/të shkollës, të përgatitet një listë me programet trajnuese sipas prioriteteve e cila u jepet mësimdhënësve. Kjo do të kontribuonte po ashtu në bashkërendimin e aktivitetet ndërmjet palëve të interesit të përfshira në ofrimin e programeve për ZHPM-së (MASH-i, komunat, OJQ-të, Fakulteti i Arsimit etj.).

- 7. Zbatimi i Udhëzimit Administrativ Nr. 19/2018 për themelimin dhe funksionimin e Qendrave Mësimore** – Një prej praktikave më të mira që është identifikuar në nivel kombëtar lidhur me ofrimin e mbështetjes për fëmijët nga grupet e margjinalizuara janë Qendrat Mësimore të cilat kanë pasur ndikim të madh në përmirësimin e pjesëmarrjes në sistemin arsimor dhe në performancën të fëmijëve/nxënësve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptianë në shkollë. Duke ditur se themelimi dhe funksionimi i QM-ve është veçse i rregulluar, MASH-i duhet të ndajë buxhet dhe të ndërmarrë hapat e nevojshëm për zbatimin e tij në mënyrë që të sigurohet qëndrueshmëria e tyre.
- 8. Fuqizimi i mekanizmave monitorues në nivel qendror dhe lokal** – Përkundër faktit se Kosova ka një kornizë legjislative e cila synon të sigurojë barazinë në arsim, mungesa e mekanizmave të monitorimit dhe mbështetjes për të siguruar llogaridhënie ndikon negativisht në zbatimin e tyre. Prandaj, paraqitet nevoja për të qartësuar përgjegjësitë ndërmjet autoriteteve qendrore dhe lokale në drejtim të sigurimit të cilësisë. Po ashtu, duhet të bëhen investime për të fuqizuar kapacitetet njerëzore në të dyja nivelet, në mënyrë që t'i realizojnë rolet e tyre për sigurim të cilësisë.



 <https://www.arisenetwork.eu>

 <https://www.facebook.com/ARISEproject/>

 <https://twitter.com/NetworkArise>



Centar za obrazovne politike
Centre for Education Policy



STEP BY STEP

